



REPUBLIKA E SHQI
AVOKATI I POPU
Seksioni i Veçantë

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 201800138/5

Tiranë ___/___/2018

Lënda : *Rekomandohet marrja e masave ligjore, për përfundimin e gjykimit të çështjes civile, midis shtetasve V. P. dhe J. P., me objekt zgjidhje martesë dhe detyrimin për pagimin e pensionit ushqimor në dobi të dy fëmijëve të mitur Ll. dhe A. P.*

Drejtuar : **Z.Dritan BANUSHI**
Kryetar i Gjykatës së Apelit

GJIROKASTËR

Për dijëni : **Zj.Elira KOKONA**
Sekretare e Përgjithshme
MINISTRIA E DREJTËSISË

TIRANË

I nderuar zoti Kryetar,

Në ankesën e saj datë 24.01.2018, drejtuar Avokatit të Popullit Zj.Erinda BALLANCA, shtetësja V. P. na shkruan se me vendimin gjyqësor me Nr.21 datë 09.01.2017, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastër ka vendosur si vijon :

Pranimin e padisë të paditëses V. P.

Zgjidhjen e martesës së lidhur me datë 17.10.2001, midis paditëses V. P. dhe të paditurit J. P. Lënien për rritje dhe edukim të fëmijëve të mitur Ll. P. e dtl.09.12.2000, dhe A. P. e dtl.29.10.2006, paditëses V. P.

Detyrimin e paditëses V. P. të lejojë të paditurin J.P. të takojë fëmijët Ll. dhe A. P. të shtunën e pare dhe të tretë të çdo muaji duke filluar ky takim nga ora 10.00 e ditës së shtunë deri në orën 18.00 të ditës së dielë, ti mbajë javën e dytë të muajit janar si dhe muajin korrik të çdo viti.

Marrja dhe dorëzimi i fëmijëve të bëhet në banesën e paditëses V. P.

Detyrimin e të paditurit J. P. të paguajë detyrimin për ushqim për sejcilin prej fëmijëve, në shumën 10.000 lekë në muaj, detyrim ky i cili fillon nga dita e ngritjes së padisë, datë 02.03.2016.

Ankusja V. P. nga ana e saj na shkruan se ky gjykim po zvaritet pa shkaqe ligjore nga Gjykata e Apelit Gjirokastër, duke u bazuar në disa kërkesa abusive dhe të padrejta të vet të paditurit J. P., të cilat mendon se ao bëhet vetëm për të shtyrë padrejtësisht gjykimin e kësaj çështje gjyqësore, për t'ju shmanguar detyrimeve ligjore që ai ka ndaj dy fëmijëve të tij të mitur.

Kundra këtij vendimi është ankuar në shkallë të dytë i padituri J. P., dhe dosja tani ndodhet për shqyrtim në Gjykatën e Apelit Gjirokastrë, dhe ajo nuk ka përfunduar akoma gjykimin e saj si rezultat i disa kërkesave abusive dhe të padrejta nga vet i padituri J. P., i cili për t'ju shmangur detyrimeve ligjore në dobi të dy vajzave të mitura, paraqet në atë Gjykatë kërkesa abusive me objekt për përjashtim të gjyqtarëve me qëllimin e vetëm për të shtyrë gjykimin sa më gjatë të jetë e mundur.

Në rastin konkret duke analizuar këtë rast *si një rast të veçantë*, që ka lidhje me interesin më të lartë të fëmijëve e cila është konsiderata parësore në çdo veprim që ka të bëjë me fëmijët dhe zvarritja e padrejtë e gjykimin nga ajo Gjykatë, cënon drejtëpërdrejtë të Drejtat e Njeriut, dhe kërkesat dhe garancitë e sanksionuara në nenin 42 të Kushtetutës së RSH, ku përcaktohet se:

”Liria, prona dhe të drejtat e njohura me Kushtetutë dhe me ligj nuk mund të cënohen pa një proces të rregullt ligjor”. “Kushdo për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe interesave Kushtetues dhe ligjor ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publikë brenda një afati të arsyeshëm”.

Po kështu bazuar në kërkesat e nenit 63/3,4 të Kushtetutës së RSH, thuhet se:

”Avokati i Popullit, ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të Drejtave të Njeriut, nga administrata publike”, dhe kërkesat e nenit 21/b të Ligjit me Nr.8454 datë 04.02.1999,”Për Avokatin e Popullit, ku përcaktohet qartë se,

“Pas përfundimit të hetimit, Avokati i Popullit, paraqet rekomandime për marrjen e masave për vënien në vend, të së drejtës së shkelur tek organi epror i organit, që ka shkatuar shkeljen”, duke marrë masa për të përfunduar së gjykuari këtë çështje gjyqësore, sa më shpejtë dhe prandaj ne edhe, ju

REKOMANDIMË :

1.*Marrjen e masave ligjore për shpejtimin dhe përfundimin e këtij gjykimi sa më shpejtë në të ardhmen nga ana juaj.*

2.*Mbi masat e marra nga ana juaj në lidhje me zbatimin e këtij rekomandimi, lutemi të njoftohemi me shkrim brenda afatit 30 ditor.*

Duke besuar në mirëkuptimi dhe bashkëpunimi tuaj,

KOMISIONERI

Arben SHKËMBI